

Vendim nr. 77 datë 05.11.2024

(V-77/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Fiona Papajorgji, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 05.11.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (S) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SOSE BUÇPAPAJ

SUBJEKT I INTERESUAR:

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, Edmond Rrushi.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimeve nr. 1209/3, datë 19.11.2014 të Komisionit të Disiplinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; nr. 1491, datë 23.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1213 (1197), datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-33, datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 23, 33, 42, 43, 48, 118, pika 3, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 137, 140, pika 2, shkronja “a” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, 13, 14 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja ka ushtruar detyrën e inspektore së ushqimit në drejtorinë rajonale të AKU-së, Kukës, konkretisht “inspektore në sektorin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë me origjinë shtazore e operatorëve të biznesit”, ndërkohë që më parë ka kryer detyra të ndryshme pranë këtij institucioni. Kontrata mes saj dhe AKU-së është lidhur në datën 10.08.2012 me afat të pacaktuar.

2. Në datën 30.06.2014 disa subjekte tregtare, veprimtaria e të cilave është kontrolluar nga AKU-ja, Kukës, i janë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së me petition, duke kërkuar ndërhyrjen e institucionit për zgjidhjen e problematikave të shkaktuara nga komunikimi jo i rregullt i kërkuases. Në datën 03.07.2014 drejtuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së i është drejtuar drejtorit të drejtorisë rajonale Kukës për verifikimin e ankesës së paraqitur nga operatorët e biznesit. Për këtë qëllim, ky i fundit ka vendosur ngritjen e një grupi pune, bazuar në gjetjet e të cilit në datën 24.10.2014 i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së për ngritjen e komisionit disiplinor dhe fillimin e procedurës për marrjen e masës disiplinore ndaj kërkuases, si rrjedhojë e konstatimit të shkeljeve të rënda dhe shumë të rënda të kryera prej saj gjatë ushtrimit të detyrës. Në datën 05.11.2014 kërkuësja është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor, si dhe për zhvillimin e seancës dëgjimore. Kjo e fundit është zhvilluar në datën 12.11.2014, ku kërkuësja ka qenë e pranishme, ka parashtruar argumentet e saj, si dhe është shprehur se observacionet për çështjen do t'i depozitonte me shkrim.

3. Në përfundim të diskutimeve në seancën e datës 19.11.2014, me vendimin nr. 1209/3, datë 19.11.2014, të dhënë në prani të kërkuases, komisioni disiplinor ka vendosur marrjen ndaj saj të masës disiplinore “*Largimi nga shërbimi civil*”, ndërsa me urdhrin nr. 1209/4 prot., datë 24.11.2014 të drejtorit të AKU-së është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës, duke filluar nga data 24.11.2014.

4. Në datën 24.12.2014 kërkuesja ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës (*Prokuroria Kukës*) ndaj kolegëve të saj, duke i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 2, i Kodit Penal (*KP*), me pretendimin se kishin falsifikuar të dhënat e procesverbaleve të inspektimit të disa subjekteve të kontrolluara më parë prej saj, të cilat në vijim ishin konstatuar si shkelje të saj. Në kushtet e moskompetencës së kësaj prokurorie, çështja i ka kaluar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, e cila ka vendosur kalimin e saj për gjykim. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka vendosur deklarinim të pafajshëm të të akuzuarve. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa për rekursin e prokurorisë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin. Kërkuesja i është drejtuar në vijim Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar, për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, të aksesit të lidhur me të drejtën për t’u mbrojtur, ankimit efektiv, marrjes së provës në mënyrë të paligjshme, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit dhe parimit të sigurisë juridike. Me vendimin nr. 67, datë 05.04.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të moslegjitimitit *ratione personae* të kërkueses, pasi interesi i saj substancial në çështje lidhej me procesin gjyqësor administrativ, i cili ishte ende në shqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

5. Po kështu, paralelisht me procesin penal, në datën 30.12.2014 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi për shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ nr. 1209/4 prot., datë 24.11.2014 të AKU-së, rikthimin e saj në detyrën e mëparshme dhe pagesën e pagës deri në momentin e rikthimit në detyrë. Me vendimin nr. 1491, datë 23.03.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

6. Kërkuesja ka ushtruar ankim kundër këtij vendimi. Në përfundim të shqyrtimit të tij, me vendimin nr. 1213 (1197), datë 23.03.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e gjetur atë të drejtë e të bazuar në ligj.

7. Kërkuesja ka ushtruar rekurs ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Me vendimin nr. 00-2024-33, datë 11.01.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se: (i) ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), (ii) në të nuk ngriheshin pretendime se vendimet e gjykatave më të ulëta binin ndesh me praktikën e konsoliduar të

Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të saj, si dhe se (iii) vendimet ishin marrë në zbatim të drejtë të ligjit.

8. Në datën 11.04.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pas plotësimit sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.04.2024. Në datat 27.05.2024 dhe 28.05.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës me kërkesa për përjashtimin e katër gjyqtarëve kushtetues, për të cilat, me vendimet e datave 10.06.2024 dhe 25.06.2024, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin. Në vijim, në datën 21.06.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa në datën 10.07.2024 kjo e fundit ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi:

9.1.1.1. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë paragjykuar çështjen, duke nxjerrë qëllimisht konkluzione të gabuara se ajo nuk kishte përmbushur detyrat e saj funksionale. Gjyqtarja e gjykatës së shkallës së parë ka bërë rolin e avokates së AKU-së, ndërsa ka trajtuar formalisht provat e paraqitura nga kërkesja. Gjykata e apelit nuk ka vlerësuar qëllimisht faktin e marrjes në përgjegjësi penale të 4 ish-kolegëve të kallëzuar penalisht prej saj, si dhe aktekspertimin e Policisë Shkencore për falsifikimin prej tyre të dokumenteve, ndërsa Gjykata e Lartë ka zhdukur qëllimisht praktikën në lidhje me kërkesën e saj për përjashtimin e relatorit, gjyqtarit S.S. Vendimi nr. 1, datë 04.04.2023 i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës së saj për përjashtimin e këtij gjyqtari është marrë nën ndikimin e tij.

9.1.1.2. Gjykata e shkallës së parë ka shkelur qëllimisht nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), pasi nuk ka vendosur pezullimin e gjykimit, ndonëse ishte vënë në dijeni se për thelbin e konfliktit kërkesja kishte paraqitur kallëzim penal. Sipas procesverbalit të seancës, të mbajtur qëllimisht nga gjykata në kundërshtim me urdhrin nr. 359, datë 05.09.2013 "*Për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore apo të veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë*

seance” të ministrit të Drejtësisë (*urdhri nr. 359/2013 i ministrit të Drejtësisë*), rezulton se kërkuësja ka pranuar zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, ndërkohë që ajo i kishte kërkuar gjykatës marrjen e provave nga AKU-ja, kërkesë kjo që nuk është marrë parasysht. Një pjesë e mirë e provave nuk janë administruar në fashikullin gjyqësor ose janë zhdukur. Këto veprime janë bërë me qëllim të paracaktuar për rrëzimin e kërkesës së saj.

9.1.1.3. Ndonëse ishte caktuar si relator, gjyqtari i Gjykatës së Lartë S.S. nuk ka marrë pjesë në trupin gjykues për shqyrtimin e çështjes së saj pikërisht për shkak të konfliktit të interesit. Shqyrtimi i rekursit është zvarritur qëllimisht nga ky gjyqtar.

9.1.2. *Së drejtës për t’u njoftuar, për të marrë pjesë, për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova e për t’u asistuar, si dhe së drejtës për ankim efektiv*, pasi nuk është vënë në dijeni për shkeljet e pretenduara nga eprori direkt, në cenim të nenit 23, pika 1, të Kushtetutës. Në cenim të akteve ligjore në fuqi, shkresa e këtij të fundit për fillimin e procedurës disiplinore nuk i është drejtuar komisionit disiplinor në AKU, por Drejtorisë së Përgjithshme të këtij institucioni, në shkelje të nenit 118, pika 3, të Kushtetutës. Po kështu, ajo nuk është lejuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga komisioni i disiplinës. Gjykatat e faktit nuk kanë pranuar provat e kërkueses dhe pretendimet e saj nuk janë marrë parasysht prej tyre. Seancat gjyqësore janë zhvilluar vetëm formalisht, pa prezencën e AKU-së. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar çështjen në seancë plenare me praninë e palëve, me qëllim që AKU-ja t’u përgjigjej pyetjeve mbi bazën e fakteve dhe provave që tregonin se largimi i saj nga detyra ishte bazuar në akte të falsifikuara.

9.1.3. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi ndonëse i është drejtuar Gjykatës së Lartë me 3 kërkesa për përshpejtimin e gjykimit, çështja e saj është gjykuar nga kjo gjykatë më vonë se çështje të tjera të regjistruara më pas. Mendimi i këshilltarit ligjor për trajtimin e çështjes me përparësi nuk është marrë parasysht.

9.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në rastin e saj janë respektuar procedurat e parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil, ndërkohë që në prapësimet e veta AKU-ja ka argumentuar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë në zbatim të

dispozitive të Kodit të Punës. Kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuesja. Vendimet gjyqësore të të tria shkallëve janë arsyetuar vetëm formalisht, mbi bazën e provave të paraqitura nga AKU-ja, ndërkohë që gjykatat nuk kanë analizuar asnjë provë të saj. Gjykata e Lartë nuk ka analizuar shtesën e rekursit të kërkueses, parashtrimet e datës 12.06.2020, kërkesën e datës 13.12.2023 dhe kërkesën paraprake urgjente të datës 15.12.2023, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës së saj për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore në prani të palëve. Kjo gjykatë është mjaftuar me një arsyetim gjysmë faqe.

- 9.2. *Së drejtës për t'u informuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për dorëheqjen e relatorit S.S. ose shkaqet e kësaj dorëheqjeje, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës së saj të datës 08.11.2023 për arsytet e mospërsheptimit të gjykimit të çështjes ose kërkesave për shkaqet e zhdukjes ose fshehjes së praktikës në lidhje me kërkesën për përjashtim të gjyqtarit S.S. Vendimi nr. 1, datë 04.04.2023 i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës së saj për përjashtimin e gjyqtarit S.S. nuk ndodhet në dosjen administrative.
- 9.3. *Së drejtës për të marrë dokumentacionin e kërkuar*, të garantuar nga neni 48 i Kushtetutës, pasi prej 10 vjetësh është shkëlur e drejta e saj për të marrë procesverbalet e inspektimit, sipas përmbajtjes së konstatuar nga raporti i auditit nr. 3741/1 prot., datë 05.09.2014. Ndonëse ka kërkuar marrjen e këtyre procesverbaleve nga gjykata e shkallës së parë, kërkesa është rrëzuar me vendim të ndërmjetëm të gjykatës. Po kështu, ndonëse kishte një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për marrjen e këtyre procesverbaleve nga AKU-ja, as shërbimi përmbarimor, as strukturat antikorrupsion nuk kanë arritur të mundësojnë vënien e tyre në dispozicion të saj.
- 9.4. *Parimit të sigurisë juridike dhe parimit të mosdiskriminimit*, pasi largimi i saj nga detyra ka qenë i padrejtë.
- 9.5. ***Subjekti i interesuar, AKU-ja***, ka prapësuar se pretendimet e kërkueses janë shqyrtuar nga gjykatat, të cilat kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Ato kanë bërë një analizë tërësore dhe objektive të provave, duke i vlerësuar në bazë të bindjes së tyre të brendshme. Zgjidhja e mosmarrëveshjes është bërë në përputhje me nenin 116 të KPC-së. Po kështu, gjykatat u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkueses, në garantim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*. Gjykata e apelit ka argumentuar

në mënyrë shteruese pretendimet e saj, duke interpretuar saktë ligjin e zbatueshëm material nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji për nëpunësin civil*), si dhe duke pasur në vëmendje edhe praktikën e Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij, si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, ndër të tjera, edhe si rrjedhojë e zhvillimit të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë në mungesë të AKU-së. Për sa i përket këtij pretendimi, Gjykata vëren se, në thelb, ai ka të bëjë me të drejtat procedurale të personave të tjerë, ndaj kërkuësja nuk legjitimohet *ratione personae* në lidhje me të, pasi nuk ka provuar të drejtën e cenuar për këtë shkak dhe interesin e ligjshëm vetjak të saj. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata çmon se kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin administrativ dhe atë gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës

me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesja ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Nga shqyrtimi i akteve që kërkesja i ka bashkëlidhur ankimit individual kushtetues dhe akteve të dosjes gjyqësore, Gjykata konstaton se në to nuk gjendet ndonjë kërkesë e kërkueses drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procesit bazuar në nenet 399/1 e vijues KPC-së. Për këto të fundit, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se janë mjete juridike që ofrojnë rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese dhe vetëm pasi t'i ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen prej tyre nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, individi mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për pasojë pretendimi i saj për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Në lidhje me pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të mosdiskriminimit, Gjykata evidenton se në dosjen gjyqësore të tërhequr për qëllime të gjyimit kushtetues rezulton e administruar një ankesë e saj drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kundër vendimit të largimit të saj nga puna. Pavarësisht këtij fakti, nuk ka ndonjë të dhënë nëse ky ankim i është dërguar Komisionerit ose që në lidhje me të të ketë një qëndrim të këtij të fundit. Po kështu, çështja e diskriminimit rezulton të jetë shtruar për herë të parë në kërkesën paraprake urgjente të datës 15.12.2023 drejtuar Gjykatës së Lartë, në drejtim të largimit të padrejtë nga puna pa shkaqe të ligjshme dhe nuk rezulton të jetë ngritur në gjykatat e faktit, për pasojë nuk ka një qëndrim të tyre për këtë pretendim të saj. Në këto kushte, edhe në lidhje me këtë pretendim, Gjykata çmon se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës.

16. Për sa i takon pretendimit se gjykata e shkallës së parë nuk e ka mbajtur procesverbalin e seancës nëpërmjet regjistrimit audio, konform parashikimeve të urdhrin nr.

359/2013 të ministrit të Drejtësisë, Gjykata vëren se kërkesja ka qenë e pranishme gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe ka marrë dizeni për mënyrën e mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore. Në datën 18.05.2015 ajo i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për vënien në dispozicion të materialeve të dosjes gjyqësore, ndërkohë që në ankimin drejtuar kësaj gjykate, por edhe gjatë procesit në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ka ngritur ndonjë pretendim në këtë drejtim, duke e parashtruar atë për herë të parë në shtesën e rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë, ndaj Gjykata vlerëson se kërkesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion edhe për këtë pretendim, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit fillimisht të procesit administrativ dhe më pas atij gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimit të organit administrativ dhe vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Për sa i takon legjitimitimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata evidenton se vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.01.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.04.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae* kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspekt të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, së drejtës për t’u njoftuar, për të marrë pjesë, për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për t’u asistuar, për ankim efektiv, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, parimit të sigurisë juridike, si dhe së drejtës për t’u informuar e së drejtës për të marrë informacionin e kërkuar.

20. Pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkesja e ka ngritur në disa drejtime duke parashtruar se: (i) gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kërkesën e saj për pezullimin e gjykimit, nuk ka marrë parasysh kërkesën e saj për të detyruar AKU-në për të paraqitur prova, nuk ka pranuar provat e depozituara nga kërkesja, si dhe nuk ka mbajtur procesverbalin e seancës sipas urdhrit nr. 359/2013 të ministrit të Drejtësisë; (ii) gjykata e apelit nuk ka vlerësuar qëllimisht aktin e ekspertimit të kryer gjatë procedimit penal; (iii) Gjykata e Lartë ka zhdukur qëllimisht praktikën në lidhje me kërkesën e saj për përjashtimin e relatorit, gjyqtarit S.S. dhe vendimi nr. 1, datë 04.04.2023 i kësaj

gjykate për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e këtij gjyqtari është marrë nën ndikimin e këtij të fundit.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Sipas Gjykatës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithashtu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret, Gjykata çmon se pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si rrjedhojë e mospezullimit të gjykimit të çështjes nga gjykata e shkallës së parë, për shkak të procesit penal të iniciuar nga kërkuesja ndaj kolegëve të saj, janë të pabazuara, pasi kërkuesja ka pasur mundësinë që gjatë gjykimit administrativ të parashtronte edhe pretendimet e saj për falsitetin e provave, për të cilat ka vënë në lëvizje procesin penal, sipas rregullave procedurale civile të zbatueshme për këtë qëllim. Ndërsa, pretendimet e tjera të parashtruara në lidhje me paanshmërinë e gjykatave të faktit kanë të bëjnë me vlerësimin nga këto gjykata të fakteve dhe provave, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues. Gjithashtu, pretendimet për ndikimin e gjyqtarit S.S. në marrjen e vendimit nr. 1, datë 04.04.2023, përmes të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës për përjashtim e tij, nuk rezultojnë të argumentuara në këndvështrimin kushtetues, ndërsa për sa i takon praktikës për përjashtimin e këtij gjyqtari, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesja, kërkesa e saj dhe vendimi nr. 1, datë 04.04.2023 i Gjykatës së Lartë janë administruar në dosjen gjyqësore të kësaj gjykate. Për më tepër, Gjykata vëren se për sa i përket trupës gjyqësore që ka shqyrtuar

rekursin e saj, me vendimin nr. 15, datë 20.06.2023 të Këshillit të Gjykatës së Lartë, për shkak të emërimit të një gjyqtari të ri në atë gjykatë, është vendosur ndryshimi i trupës së kolegjit administrativ të kësaj gjykate, duke përcaktuar si anëtarë të saj gjyqtarët A.V., A.A. dhe E.M. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme janë të haptazi të pabazuara *ratione materiae*.

24. Kërkuësja ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si rrjedhojë e mosshqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë në seancë gjyqësore me prani të palëve. Në lidhje me të, Gjykata vë në dukje se sipas nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, ndërsa shqyrtimi në seancë gjyqësore vendoset në rastet e parashikuara nga neni 62 i këtij ligji. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit, mbi bazë dokumentesh, është forma e gjykimit që ndiqet si rregull tashmë në Gjykatën e Lartë dhe se e drejta për t'u dëgjuar nuk konsiderohet e cenuar vetëm për shkak të shqyrtimit prej saj të çështjes në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 23, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes rekursit të paraqitur nga kërkuësja, në të cilin ka parashtruar pretendimet e saj për vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, duke iu dhënë në këtë mënyrë e drejta për t'u dëgjuar para kësaj gjykate. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuësja nuk ka arritur të përcaktojë se si shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Po kështu, në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u informuar, për shkak se nuk është informuar për dorëheqjen e gjyqtarit relator në Gjykatën e Lartë, S.S., për shkaqet e zhdukjes ose fshehjes së praktikës për kërkesën për përjashtimin e këtij gjyqtari, si dhe shkaqet e mospërsheptimit të gjykimit të çështjes nga kjo gjykatë.

26. Gjykata vëren se kërkesa e kërkuases për përjashtimin e gjyqtarit S.S. është depozituar në Gjykatën e Lartë në datën 27.03.2023, ndërsa me vendimin nr. 15, datë 20.06.2023 të Këshillit të Gjykatës së Lartë është ndryshuar përbërja e Kolegjit Administrativ të kësaj gjykate që kishte për shqyrtim çështjen e kërkuases, ku gjyqtari S.S. nuk rezulton më pjesë e tij. Ky vendim rezulton i publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Gjykata çmon se edhe pse kërkuases mund të mos i jetë njoftuar vendimi për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit S.S., ky fakt nuk i ka cenuar asaj ndonjë të drejtë kushtetuese, për sa kohë ai gjyqtar nuk ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar rekursin e saj. Prandaj edhe ky pretendim i kërkuases nuk gjen mbështetje në këndvështrimin kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Gjykata konstaton, gjithashtu, se në vendimin nr. 1-00-2023, datë 04.04.2023 të gjyqtarës së vetme të Gjykatës së Lartë, kërkuësja ka marrë përgjigje edhe për pretendimet e saj për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes. Kështu, gjyqtarja ka arsyetuar se ndërsa palët kanë të drejtë që, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”, të kërkojnë përshpejtimin e gjykimit të çështjes, vendimi i gjyqtarit për këtë kategori kërkesash kufizohet vetëm në disponim pranues ose refuzues, pa qenë e nevojshme që qëndrimi të arsyetohet hollësisht. Bazuar në nenet 482 dhe 460 të KPC-së, gjyqtari planifikon çështjen për gjykim, duke mbajtur në konsideratë radhën e ardhjes së saj në gjykatë. Po sipas gjyqtarës, përjashtimisht kërkesa për përshpejtimin e gjykimit të një çështjeje jashtë kësaj radhe lejohet vetëm për shkaqe të rënda e të motivuara, të cilat mbeten në vlerësimin e gjyqtarit (*shih faqet 2-3, paragrafi 8, të vendimit nr. 1-00-2023, datë 04.04.2023 të Gjykatës së Lartë*). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se edhe pretendimet e kërkuësës për mosinformimin për shkaqet e mospërshpejtimin të gjykimit të rekursit të saj nuk gjejnë mbështetje në aspektin kushtetues.

28. Në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi prej 10 vjetësh është në pamundësi të marrjes së procesverbaleve të inspektimit, sipas përmbajtjes së tyre të konstatuar nga raporti i auditit. Gjykata e çmon të pabazuar këtë pretendim, pasi sipas materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konkretisht shkresës nr. 3880/1 prot., datë 25.09.2020 të AKU-së; kthim-përgjigjes nr. 1732/1 prot., datë 12.05.2021 e AKU-së; shkresës nr. S-96, datë 03.03.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion të Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se AKU-ja ka vënë në dispozicion të saj materialin e kërkuar. Për më tepër, ky fakt përbën një ndër kërkimet e saj gjatë procesit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe gjykatat i kanë dhënë përgjigje, duke arsyetuar se ajo i dispononte procesverbalet e pretenduara dhe kishte refuzuar t’ia dorëzonte ato AKU-së, duke i administruar si personale (*shih faqen 8 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*); mosdorëzimi i tyre së bashku me shkeljet e tjera të konstatuara përbënin shkelje të rëndë të detyrës (*shih faqen 18 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*); pretendimet në lidhje me këto prova dilnin jashtë funksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih faqen 13 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuësës nuk mund të merret në shqyrtim.

29. Po kështu, për sa i takon pretendimit të kërkuësës për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata vëren se ai është parashtruar në mënyrë të përgjithshme, pa u përcaktuar se në ç’drejtim është cenuar, ndaj çmon se kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë cenimin e tij në aspektin kushtetues.

30. Për sa u përket pretendimeve të tjera për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, për të marrë pjesë, për t'u dëgjuar, për t'u asistuar, për ankim efektiv, si dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, duke pasur parasysh argumentet në thelb të tyre, Gjykata çmon t'i analizojë ato në vijim në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar gjatë procesit administrativ dhe atij gjyqësor të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

31. Kërkesja ka pretenduar se ajo nuk është vënë në dijeni për shkeljet e pretenduara nga eprori direkt dhe nuk është lejuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga komisioni i disiplinës. Shkresa për inicimin e procedurës disiplinore nuk i është drejtuar komisionit disiplinor në AKU, por Drejtorisë së Përgjithshme të këtij institucioni, ndërkohë që fillimi i ecurisë disiplinore duhej të ishte bërë nga eprori direkt dhe jo nga komisioni disiplinor. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh provat dhe pretendimet e saj në këtë drejtim dhe vendimet e tyre janë arsyetuar vetëm formalisht. Në prapësimet e veta AKU-ja ka argumentuar se zgjidhja e kontratës së punës është bërë në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës. Po sipas kërkeses, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar shtesën e rekursit të saj, parashtrimet e saj të datës 12.06.2020, kërkesën e saj të datës 13.12.2023 dhe kërkesën paraprake urgjente të datës 15.12.2023, si dhe nuk i ka dhënë përgjigje kërkesës për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore me prani të palëve.

32. Subjekti i interesuar, AKU-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkeses janë shqyrtuar nga gjykatat e faktit, të cilat kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes. Gjykatat kanë bërë një analizë tërësore dhe objektive të provave, duke i vlerësuar ato në bazë të bindjes së tyre të brendshme. Zgjidhja e mosmarrëveshjes është bërë në përputhje me nenin 116 të KPC-së. Po kështu, gjykatat u kanë dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkeses, në garantim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

33. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Sipas Gjykatës, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën se si kanë vepruar organet e pushtetit publik, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi administrativ ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe, në vijim, nëse gjykatat e

zakonshme, që kanë shqyrtuar veprimet dhe vendimmarrjen e organit administrativ, kanë vepruar në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është në radhë të parë funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, Gjykata ka pohuar se kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që përpara marrjes së vendimit gjyqësor të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 7, datë 12.03.2010; nr. 12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka theksuar se mospasqyrimi në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë i shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në shtesën e rekursit, përbën cenim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, në rastin konkret Gjykata do të vlerësojë nëse gjatë procesit administrativ kërkueses i është dhënë mundësia për t'u dëgjuar për pretendimet e saj përpara nxjerrjes nga organi administrativ të urdhrin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe nëse vendimmarrja e këtij organi është vlerësuar nga gjykatat në kuadër të garancive që ofron neni 42 i Kushtetutës për proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim do të analizohet nëse gjykatat kanë marrë në shqyrtim pretendimet e saj në këndvështrim të së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

37. Gjykata vëren se, sipas materialeve të dosjes gjyqësore, me shkresën nr. 1209, datë 05.11.2014 të AKU-së kërkuesja është njoftuar për fillimin e procedimit disiplinor. Po kështu, sipas procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 12.11.2014 nga komisioni disiplinor, rezulton se kërkuesja ka qenë e pranishme në këtë seancë, ku dhe ka depozituar një sërë dokumentesh, ndërkohë që ka refuzuar të nënshkruajë procesverbalin e mbajtur. Në datën 19.11.2014 komisioni është mbledhur për të votuar në lidhje me çështjen, duke u shprehur se në përfundim të procesit kërkuesja do të njoftohej në lidhje me rekomandimet ose vendimin e marrë. Me vendimin nr. 1209/3 të po kësaj date, të dhënë në prani të kërkueses, komisioni disiplinor ka vendosur marrjen ndaj saj të masës disiplinore “Largimi nga shërbimi civil” (*shih faqet 47, 394-398, 409 dhe 420-421 të dosjes gjyqësore*).

38. Në kërkesëpadinë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe argumentet ligjore përfundimtare të saj në këtë gjykatë kërkuesja ka pretenduar, ndër të tjera, se në procedimin administrativ nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil, pasi ajo nuk është lejuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga komisioni i disiplinës, duke dërguar në këto kushte pretendimet e saj me postë. Po sipas saj, shkresa e eprorit direkt për fillimin e procedurës disiplinore nuk i është drejtuar komisionit disiplinor në AKU, por Drejtorisë së Përgjithshme të këtij institucioni, ndërkohë që fillimi i ecurisë disiplinore duhej të ishte bërë nga eprori direkt dhe jo nga komisioni disiplinor. AKU-ja ka prapësuar se lidhja e kontratës së punës është bazuar në dispozitat e Kodit të Punës dhe njoftimi i saj për bisedime në lidhje me vazhdimin e kësaj kontrate dhe për seancën dëgjimore në lidhje me ecurinë disiplinore është bërë në përputhje me dispozitat e këtij kodi.

39. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke vlerësuar se vendimi i komisionit të disiplinës ishte marrë në përputhje me parimin e ligjshmërisë, në respektim të procedurës së parashikuar në ligjin për statusin e nëpunësit civil dhe parimit të dëgjimit. Po sipas gjykatës, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit barra e provës për të provuar ligjshmërinë e aktit ose veprimit i takon organit administrativ, AKU-ja ka paraqitur vendimin nr. 1209/4, datë 24.11.2014, në të cilin pasqyrohet prezenca e kërkueses. Kërkuesja ka pretenduar se nuk ka qenë e pranishme në gjykimin administrativ, ndërkohë që, në zbatim të parimit të procedurës civile, sipas të cilit pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin që në përputhje me ligjin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimet e saj, ajo nuk ka arritur të provojë gjatë gjykimit pretendimet se nuk ishte lejuar të merrte pjesë në seancën dëgjimore të komisionit disiplinor dhe nuk kishte paraqitur prova direkte ose indirekte që provonin këtë fakt (*shih faqet 7-9 të vendimit nr. 1491, datë 23.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

40. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është gjetur i drejtë nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vlerësuar se në zhvillimin e procedurës disiplinore AKU-ja nuk ka shkelur kërkesat procedurale të parashikuara nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në fuqi. Kërkesja është njoftuar për fillimin e procedurës disiplinore, duke iu dhënë mundësia të parashtronte pretendimet e saj. Gjatë hetimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë ka rezultuar e provuar se ajo ka qenë prezent në seancën e datës 12.11.2014 të zhvilluar nga komisioni disiplinor, gjatë së cilës ka parashtruar pretendimet e saj, ndonëse nuk ka pranuar të nënshkruajë procesverbalin e mbajtur. Po kështu, ajo ka qenë e pranishme edhe në seancën e datës 19.11.2014, fakt ky që rezulton nga përmbajtja e vendimit të komisionit disiplinor. Nga ana tjetër, ndonëse shkresa për fillimin e procedurës disiplinore nuk i është drejtuar shprehimisht komisionit disiplinor, fakti që i është drejtuar AKU-së nënkupton se i është drejtuar këtij komisioni, si organi disiplinor me kompetencën e zhvillimit të procedurës disiplinore, sipas pikës 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, e cila përcakton se në rastet e shkeljeve të lehta ecuria disiplinore iniciohet nga eprori, ndërsa në rastet e shkeljeve të rënda, siç është dhe rasti i saj, nga komisioni disiplinor (*shih faqet 10-13 të vendimit nr. 1213 (1197), datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit*).

41. Kërkesja ka ushtruar rekurs në datën 24.04.2017, duke ngritur, në thelb, të njëjtat pretendime që ka ngritur para gjykatave të faktit. Po kështu, në datën 12.06.2020 ajo ka depozituar parashtrime në Gjykatën e Lartë, ku ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë nuk ka urdhëruar paraqitjen e provave nga pala tjetër, administrimi i të cilave ka qenë i rëndësishëm për gjykimin e çështjes, ndërsa në datën 17.03.2022 ka paraqitur shtesë rekursi, duke parashtruar se disa seanca gjyqësore janë zhvilluar vetëm formalisht, pasi pala e paditur është paraqitur vetëm në seancën e parë; një pjesë e provave nuk janë administruar në dosjen gjyqësore, ndërsa të tjera janë zhdukur pa u inventarizuar; ato janë vlerësuar nga gjykatat vetëm formalisht; procesverbali i seancës gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë është falsifikuar dhe kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj për marrjen e provave nga AKU-ja; veprimet e gjyqtarës janë bërë me qëllim të paracaktuar për rrëzimin e kërkesës së saj; gjykata e apelit nuk ka marrë në konsideratë e vlerësuar provat e reja të dërguara nga kërkesja, të cilat ishin zhdukur nga dosja gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë, si dhe nuk ka vlerësuar provat shkencore që provonin falsifikimin e dokumenteve; AKU-ja dhe gjykatat nuk kanë vënë në dispozicion të kërkuarës provat e kërkuara prej saj; Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së nuk i ka vënë në dispozicion procesverbalet e inspektimit, sipas përmbajtjes së tyre të konstatuar

nga raporti i auditit, çka tregon se ky raport ka qenë fiktiv dhe i falsifikuar; gjykata e apelit është treguar e njëanshme ndaj saj, duke e paragjykuar.

42. Po kështu, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë në datën 13.12.2023, duke kundërshtuar vendimin nr. 01-00-2023, datë 04.04.2023 të gjyqtarës së vetme të kësaj gjykate, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës së saj për përjashtimin e gjyqtarit S.S. nga gjykimi i çështjes. Në këtë kërkesë ajo ka kërkuar edhe gjykimin e çështjes nga gjykata në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Ndërsa, në kërkesën urgjente të datës 15.12.2023 kërkuesja ka pretenduar cenimin e parimit të mosdiskriminimit, si rrjedhojë e largimit të saj nga puna pa shkaqe të ligjshme, si dhe ka ripërsëritur argumentet e parashtruara në rekurs e ato të parashtruara në kërkesat e depozituara në vijim të tij.

43. Me vendimin nr. 00-2024-33, datë 11.01.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Sipas këtij kolegji, pretendimet e kërkueses janë shqyrtuar nga gjykatat e faktit, të cilat kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimit të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Në përputhje me parashikimet e nenit 126 të KPC-së, gjykatat kanë bërë analizë tërësore dhe objektive të provave, duke i vlerësuar ato në bazë të bindjes së tyre të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësi i rrethanave të çështjes, duke zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Po kështu, në interpretim të drejtë të ligjit material për statusin e nëpunësit civil, gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë shteruese për të gjitha pretendimet e kërkueses të parashtruara në rekurs. Nga ana tjetër, pjesa e pretendimeve që ngrenë çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të saj (*shih faqet 12-13 të vendimit nr. 00-2024-33, datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

44. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata vëren se nga dokumentacioni i dosjes gjyqësore rezulton se gjatë procesit administrativ kërkueses i është dhënë mundësia për t'u njohur me faktet që e kanë ngarkuar me përgjegjësi administrative, si dhe të paraqesë argumente e prova në mbështetje të pretendimeve të saj, në garantim të së drejtës për t'u dëgjuar përgjatë këtij procesi. Po kështu, Gjykata vë në dukje se pretendimet në lidhje me këtë proces janë parashtruar nga kërkuesja edhe gjatë procesit gjyqësor. Gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është zhvilluar në prani të kërkueses dhe përfaqësuesit të saj ligjor, i cili ka parashtruar pretendimet e saj, përfshirë edhe ato për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar gjatë procesit disiplinor. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë janë vënë në lëvizje përmes ankimit dhe rekursit të kërkueses, ku janë parashtruar argumentet e saj për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar gjatë procesit administrativ. Pretendimet e kërkueses në këtë drejtim janë analizuar dhe vlerësuar

nga gjykatat përkundrejt parashikimeve të ligjit material e procedural dhe gjykatat kanë arsyetuar qëndrimet e tyre në lidhje me to, ndaj për sa i takon të drejtës së kërkuases për t'u dëgjuar gjatë procesit administrativ, Gjykata çmon se vendimmarrja e gjykatave rezulton në respektim të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

45. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është arsyetuar në mënyrë të kufizuar, duke u formuluar në mënyrë standarde. Një arsyetim i tillë është pranuar nga jurisprudenca kushtetuese si në përputhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, për sa kohë që në pjesën hyrëse pasqyrohen shkaqet e ngritura në rekurs. Gjykata thekson se ky element është i rëndësishëm në rastin e arsyetimit të kufizuar të vendimit, pasi u tregon palëve se janë dëgjuar dhe çështja e tyre është vlerësuar nga Gjykata e Lartë. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se në vendimin e Gjykatës së Lartë janë pasqyruar shkaqet e parashtruara nga kërkuësja në rekurs në lidhje me procesin administrativ, ndërkohë që nuk kanë gjetur pasqyrim shkaqet e parashtruara prej saj në shtesën e rekursit, parashtrimet dhe në kërkesat e tjera të paraqitura në Gjykatën e Lartë, edhe pse në thelb ato kishin të bënin me cenimin e së drejtës për punë të kërkuases, të garantuar në nenin 49 të Kushtetutës, në aspektin procedural (procesi administrativ dhe gjyqësor i zhvilluar) dhe atë substancial. Në zbatim të standardit të arsyetimit të vendimit, Gjykata vëren se paraqitja e pretendimeve të ngritura në shtesën e rekursit, si dhe në kërkesat e parashtrimet e tjera të paraqitura nga kërkuësja duhej të ishin evidentuar në vendimin e Gjykatës së Lartë, qoftë edhe për të analizuar nëse ato ishin paraqitur apo jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.

46. Nga sa më sipër, Gjykata çmon se mungesa në vendimin e Gjykatës së Lartë të të gjitha pretendimeve të ngritura nga kërkuësja në të gjitha aktet e paraqitura përpara Gjykatës së Lartë cenon jo vetëm standardin e një vendimi të arsyetuar, por ka vënë në dyshim edhe të drejtën e kërkuases për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e saj. Në vlerësimin e Gjykatës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që, si gjykatë ligji, të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, pretendimet e ngritura në shtesën e rekursit në rastet kur ato kanë të bëjnë me të drejta kushtetuese.

47. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuases për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-33, datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 05.11.2024

Shpallur më 05.12.2024

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 8 (S) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkuases Sose Buçpapaj, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 1209/3, datë 19.11.2014 të Komisionit të Disiplinës të Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; nr. 1491, datë 23.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1213 (1197), datë 23.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-33, datë 11.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar për shkak të pabazueshmërisë së pretendimeve të kërkuases. Për këtë arsye çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Fillimisht, çmojmë të evidentojmë se ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket trajtimit në përgjithësi të pretendimeve të kërkuases, me përjashtim të atij për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në lidhje me mospasqyrimin në vendimin e Gjykatës së Lartë të shkaqeve të parashtruara nga kërkuësja në parashtrimet, shtesën e rekursit dhe në kërkesat e tjera të paraqitura nga ajo në atë gjykatë, shkak për të cilin shumica ka arritur në përfundimin se vendimi i asaj gjykate cenon jo vetëm standardin e një vendimi të arsytuar, por vë në dyshim edhe të drejtën e kërkuases për t’u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e saj. Sipas shumicës, është detyrë e Gjykatës së Lartë që, si gjykatë ligji, të arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, pretendimet e ngritura në shtesën e rekursit në rastet kur ato kanë të bëjnë me të drejta kushtetuese, ndërsa ato në rastin konkret, në thelb, kishin të bënin me cenimin e së drejtës për punë të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, në aspektin procedural (procesi administrativ dhe gjyqësor i zhvilluar) dhe atë substancial (*shih paragrafët 45-46 të vendimit*).

3. Ne, gjyqtarët në pakicë, nuk pajtohemi me këtë vlerësim të shumicës. Për këtë mbajmë në konsideratë faktet në lidhje me parashtrimet, shtesën e rekursit dhe kërkesat e tjera të paraqitura nga kërkuësja në Gjykatën e Lartë, sikurse ato janë pasqyruar kronologjikisht dhe në mënyrë të përmbledhur edhe nga shumica (*shih paragrafin 41 të vendimit*), në referim të të cilave mund të analizohet se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit mban datën 23.03.2017 dhe kërkuësja, brenda afatit ligjor 30-ditor, sipas nenit 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) dhe nenit 443, paragrafi 2, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka ushtruar recurs në datën 24.04.2017. Në vijim, në datën 12.06.2020, pra pas më shumë se 3 vjetëve nga vendimi i gjykatës së apelit, kërkuësja ka depozituar në Gjykatën e Lartë parashtrime. Më tej,

pas 5 vjetëve nga vendimi i gjykatës së apelit, në datën 17.03.2022, kërkuesja ka depozituar në atë gjykatë një shtesë rekursi. Më tej akoma, pas gati 7 vjetësh nga vendimi i gjykatës së apelit, në datën 13.12.2023 kërkuesja ka depozituar në Gjykatën e Lartë një kërkesë dhe po ashtu, në datën 15.12.2023, ka depozituar edhe një kërkesë tjetër.

4. Nga sa më lart, rezulton se parashtrimet, shtesa e rekursit dhe kërkesat e tjera të paraqitura nga kërkuesja në Gjykatën e Lartë datojnë shumë vite pas kalimit të afatit ligjor për ushtrimin e së drejtës së rekursit. Dispozitat procedurale civile në lidhje me mjetet dhe afatet e ankimit, që aplikohen edhe në gjykimin administrativ, kanë parashikuar rekursin si mjetin e ankimit në Gjykatën e Lartë (neni 442 i KPC-së), afati ligjor i paraqitjes së të cilit është 30 ditë (neni 443 i KPC-së), afat ky që sipas ligjit procedural të kohës (neni 444 i KPC-së) fillonte nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit përfundimtar. Po ashtu, dispozitat procedurale parashikojnë se shkaqet e rekursit janë përcaktuese për kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga ajo gjykatë (neni 473/a). Referuar këtyre rregullimeve ligjore, kohëzgjatja e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë nuk nënkupton dhe as mund të shërbejë si shkak për t'i dhënë palës rekursuese të drejtën për të paraqitur pretendime ose shkaqe të reja për kundërshtimin e procesit gjyqësor në gjykatat e faktit, të ndryshme apo përtej atyre të parashtruara në rekurs dhe as për të zgjeruar kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë.

5. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta e aksesit mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 40 datë 22.12.2022; nr. 18, datë 31.03.2014; nr. 17, datë 19.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se nuk është arbitrar interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për papranueshmërinë e shtesës së rekursit, interpretim sipas të cilit, bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht, ndërkohë që në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në shtesën e rekursit nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme (*shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Për rrjedhojë, vetëm fakti i mosevidentimit në rastin konkret nga Gjykata e Lartë i paraqitjes nga kërkuesja të parashtrimeve, shtesës së rekursit dhe kërkesave të tjera dhe mosarsyetime minimalist nga ajo i papranueshmërisë së tyre për shkak të paraqitjes së tyre dukshëm jashtë afatit ligjor për atë mjet ankimi, pavarësisht faktit nëse në ato akte janë parashtruar ose jo pretendime të reja të ndryshme nga ato në rekurs dhe të lejuara nga ligji, në vlerësimin tonë nuk mund të përbëjnë shkak për të arritur në përfundimin e cenimit nga Gjykata e Lartë të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe as mund të vënë në dyshim të drejtën

e kërkueses për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e ngritura në ato akte. Edhe duke pranuar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka mangësi formale në këtë aspekt, një mangësi e tillë kurrsesi nuk mund të çojë në një përfundim të ndryshëm në lidhje me të drejtat kushtetuese të pretenduara si të cenuara nga kërkuesja. Në këtë drejtim vlen të përmendet se në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Për sa më lart, mbajtëm qëndrimin se pretendimet e kërkueses në tërësi ishin të pabazuara, ndaj kërkesa e saj duhet të rrëzohej.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Ilir Toska, Genti Ibrahimi